



KUVENDI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 12.2 shkronja d) dhe 14 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenin 17 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenin 17 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe në bazë të neneve 14, 15 paragrafi 2.4, dhe nenin 17 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 mars 2026, miratoi këtë;

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunes -Njësia kadastrale P-1339-0 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Orllan me sipërfaqe prej 2106m², nga kjo Njësi kadastrale sipërfaqja e planifikuar për dhënie në shfrytëzim është 1250m² duke përfshirë objektin hotelier prej 250m², në vendin e quajtur "Fshat-Orllan" me shfrytëzim aktual oborr, shtëpi-ndërtesë, me destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale Zonë e Dytë e Mbrojtur.

Neni 1

Formohet komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës për 10-të (dhjetë) vite sipas vendimit përkatës për miratimin paraprak të vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik pronën e paluajtshme të Komunës -Njësia kadastrale P-1339-0 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Orllan me sipërfaqe prej 2106m², nga kjo njësi kadastrale sipërfaqja e planifikuar për dhënie në shfrytëzim është 1250m², duke përfshirë objektin hotelier prej 250m², në vendin e quajtur "Fshat-Orllan", në këtë përbërje;

1. **z.Vigan Salihu**, nga Ekzekutivi i Komunës
2. **znj.Ditjona Statovci**, nga Ekzekutivi i Komunës
3. **z.Haki Rudari**, nga Kuvendi i Komunës
4. **z.Isak Ejupi**, nga Kuvendi i Komunës
5. **z.Shqipdon Rushiti**, nga sektori joqeveritar lokal

Kryesuesi i Komisionit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të këtij komisioni dhe i njëjti organizon dhe kryeson punën e komisionit.

Neni 2

Mandati i Komisionit është i përkohëshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, përkatësisht për zbatimin e vendimit me nr.prot.01-463/06-0019209/26 të datës 31 mars 2026 të Kuvendit të Komunës për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Ligjin nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe Rregullores (QRK) nr.09/2020

për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Drejtoritë dhe shërbimet tjera përkatëse të Administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje këtij komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si dhe Rregullores (QRK) nr.03/2026 për procedurën e shqyrtimit të akteve të komunave.

Nr.Prot. 01-020/p4-0019211/26
Podujevë, datë; 31 mars 2026



Kryesuesi i Kuvendit
Isak Shabani